



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.372/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Besart Lokaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.372/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.372/2025, nga Besart Lokaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik "Lidhja Demokratike e Kosovës" (LDK), në të cilën theksohet se gjatë numërimit të votave dhe bartjes së formularëve të rezultatit në QKN në Deçan janë bërë shkelje nga ana e komisionerëve, duke i tjetërsuar ose duke mos i bartur në formularët e kandidatëve një numër të konsiderueshëm të votave, në qendrat e votimit si në vijim: 0104/01, 0104/02, 0104/03, 0104/04, 0103/04, 0103/02, 0107/01, 0112/01, 0114/02. Ka theksuar se këto veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të LZP-së Nr.08/L-22, përkatësisht me nenet 5 dhe 118.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, thekson se bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr.08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, në nenin 9 paragrafi 1 thekson se në rastet të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cili do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ po ashtu ju njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Tutje në përgjigje theksohet se sa i përket pretendimeve të palës ankuese se shkeljet kanë ndodhur me datë 13-15 tetor 2025 janë të pasafatshme, sepse lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, ankesat dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Pra procesi i numërimit në QKN-Deçan ka përfunduar me datë 15.10.2025 në ora 15:00 kurse pala e ka parashtruar ankesën me datë 04.11.2025. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkangjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. Pra nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e tij. Tutje, kanë shtuar se i gjithë materiali zgjedhor, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pabazuar

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër KQZ-së, me pretendimet se gjatë numërimit në QKN dhe bartjes së formularëve nga ana e komisionerëve, janë tjetërsuar duke mos i bartur në formularin e kandidatëve (FRK), me

ç'rast janë dëmtuar një numër i konsiderueshëm i votave, Paneli vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka ndodhur tjetërsimi dhe dëmtimi i votave, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova me të cilat mund të dëshmonte se ka ndodhur shkeljet e pretenduara, përkatësisht nuk i ka bashkangjitur ankesës prove tjetër bindëse dhe të qartë andaj ankuesi nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten vetëm ne suaza te dyshimit nga se këto pretendime nuk janë vertetuar me prova konkrete.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla paraqiten si te hamendsuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj. Kështu qe bazuar në të lartcekurat konkludohet se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur veprime qe janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.372/2025 më datën 05.11.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.114/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Milena Đerić dhe Franciska Zhitija - Ymeri anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.372/2025, e datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të Kuvendit Komunal, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.372/2025, e datës 05.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL. Anr.372/2025, e datës 05.11.2025, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.372/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura më datën 12 tetor 2025.



Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të LZP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës që të: aprovoj të bazuar ankesën e ankuesit dhe të prish vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.372/2025, të datës 04.11.2025, dhe çështja të i kthehet të njëjtit për rivendosje.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL.Anr.372/2025, i datës 05.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr. 372/2025, nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik "Lidhja Demokratike e Kosovës" (LDK), në të cilën theksohet se gjatë numërimit të votave dhe bartjes së formularëve të rezultatit në QKN në Deçan janë bërë shkelje nga ana e komisionerëve, duke i tjetërsuar ose duke mos i bartur në formularët e kandidatëve një numër të konsiderueshëm votash, në qendrat e votimit si në vijim: 0104/01, 0104/02, 0104/03, 0104/04, 0103/04, 0103/02, 0107/01, 0112/01, 0114/02. Ka theksuar se këto veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të LZP-së Nr. 08/L-22, përkatësisht me nenet 5 dhe 118.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se, bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr. 08/L-028, Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr. 01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj,




bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 13/2024 për Rezultatet Zgjedhore, në nenin 9 paragrafi 1, theksohet se në rastet e mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilitdo VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

KQZ-ja po ashtu njofton se procesi i numërimit të votave në QNR është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Tutje, në përgjigje theksohet se sa i përket pretendimeve të palës ankuese se shkeljet kanë ndodhur me datë 13 - 15 tetor 2025, janë të pasafatshme, sepse lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, ankesat dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Pra, procesi i numërimit në QKN - Deçan ka përfunduar më datë 15.10.2025 në orën 15:00, kurse pala e ka parashtruar ankesën më datë 04.11.2025. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. Pra, nuk ka bashkëngjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e tij. Tutje, kanë shtuar se i gjithë materiali zgjedhor gjendet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL.Anr.372/2025, të datës 05.11.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të tij ndër të tjera ka theksuar se: Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoi se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Besart Lokaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitura kundër KQZ-së, me pretendimet se gjatë numërimit në QKN dhe bartjes së formularëve nga ana e komisionerëve janë tjetërsuar duke mos i bartur në formularin e kandidatëve (FRK), me ç'rast janë dëmtuar një numër i konsiderueshëm votash, Paneli vlerësoi se janë të paqenësishme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka ndodhur tjetërsimi dhe dëmtimi i votave, paneli nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur shkelje apo parregullsi për të



cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij. Kjo, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkëngjitur prova me të cilat mund të dëshmonte se kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, përkatësisht nuk i ka bashkëngjitur ankesës provë tjetër bindëse dhe të qartë. Andaj, ankuesi nuk ka arritur me ankesë të argumentojë pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendimet e theksuara në ankesë tani për tani mbeten vetëm në suaza të dyshimit, ngase këto pretendime nuk janë vërtetuar me prova konkrete.

Andaj, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla paraqiten si të hamendësuara, të paargumentuara dhe të paqenësishme dhe si të tilla i refuzoi. Kështu që, bazuar në të lartcekurat, konkludohet se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur veprime që kanë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës, në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* Nga arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar të pabazuar ankesën e ankuesit Besart Lokaj, për shkak të shpalljes së rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale, që janë mbajtur më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejnë edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet e ankuesit, Besart Lokaj, përkitazi me numrin e votave të fituara në Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më 12 tetor 2025, në Komunën e Deçanit, ku ndër të tjera theksim.



pretendimeve të tij vihet në: dyshimet për tjetërsim ose mos bartje të votave gjatë procesit të bartjes së rezultateve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) - Deçan; mospërputhjen ndërmjet numrit të votave të evidentuara nga vëzhguesit dhe atyre të shënuara në formularët zyrtarë; mungesën e votave të familjarëve dhe mbështetësve të tij politikë në disa qendra votimi; si dhe në faktin që PZAP-ja ka refuzuar ankesën pa zhvilluar verifikim apo hetim të materialit zgjedhor, ndonëse kjo procedurë parashihet në nenin 15 të Rregullores Nr. 01/2025.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i shqyrtoj në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoj në tërësi si të pathemelta, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk ka pasur mundësi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidatin, ashtu siç pretendon i njëjti, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në procedurën e ankimimit. Ankuesi edhe pse me ankesë në Gjykatën Supreme ka përmendur persona me iniciale dhe numra të letërnjoftimit si dhe Qendrat e Votimit, kjo prapë se prapë nuk përbën bazë të mjaftueshme për të provuar pretendimet ankimore për të proceduar në hetim të brendshëm sepse madje nuk ka as deklarata të personave në fjalë, janë iniciale dhe numra personal të vendosur në ankesë nga vet subjekti ankuese gjë që nuk e ka fuqinë e provës sepse përbën pretendim por jo edhe provim të ekzistimit në manipulimit të votave.

Sipas nenit 117 [Procedurat e PZAP-së] par.3 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*, si dhe neni 13 [Vendimarrja e PZAP-it] të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, ku përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, dhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, përcaktuese për ligjshmërinë e vendimit të PZAP, është fakti se ankuesi ka parashtuar pretendime të paprovuara për mos bartjen apo tjetërsimin e votave. Pretendimet për dëshmi në bazë të referimit në emrat e votuesve, me inicialet dhe me numrat personal të identifikimit sipas



qendrave të votimit, pa asnjë indikacion tjetër se ka pasur pa rregullsi në vendvotimet e pretenduar, janë të pathemelta sepse çdo pretendim i ankuesit duhet të provohet në masë të besueshme për të krijuar bazë për rinumërim, apo edhe për një vendim tjetër, prandaj në këtë rast këto pretendime janë pa ndikim për të vendosur ndryshe.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se, pretendimet e paditësit të pa mbështetura në asnjë provë materiale, nuk provojnë në mënyrë të besueshme manipulimin e rezultatit të kandidatit, dhe nuk përbëjnë shkak për të urdhëruar rinumërimin në vendvotimet e pretenduara, ndërsa PZAP ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka vlerësuar drejt faktet dhe provat në dosjen përkatëse.

Mbi barrën e provës dhe standardin ligjor: Sipas nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe barra e provës bie mbi palën ankuese."* Në këtë rast, ankuesi, nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të mbi bazën e të cilës për gjykatën do të krijohet bindja që në rastin konkret duhet të urdhërohet rinumërimi. Prandaj, edhe PZAP me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e tij nuk mbështeten në prova faktike apo juridike, dhe ka refuzuar ankesën.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.114/2025, më datë 13 nëntor 2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-114/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIM
13. 11. 2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Priloga 13.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
i, duke shkruar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
indiac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostiljac,
om zasto primilac nije stavio svoj potpis.

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrati)